

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1042 Prot.

Tiranë, më 02.08 2017

VENDIM Nr. 169, datë 26.07.2017

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), VKM Nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave të dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtimet me leje", Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.10, të datës 26.07.2017, pasi shqyrtoi Kërkesën e ALUIZNI-it Durrës për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit të Z. Shkëlqim Safet Hodaj dhe legalizimit të objektit të Znj. Rronja Hysen Hodaj, Lagja Nr. 8, Rruga "Eqerem Shijaku" Durrës", Zona Kadastrale 8512, që pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit,

VENDOSI:

1. Të miratojë Kërkesën e ALUIZNI-it Durrës për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit të Z. Shkëlqim Safet Hodaj dhe legalizimit të objektit të Znj. Rronja Hysen Hodaj, Lagja Nr. 8, Rruga "Eqerem Shijaku" Durrës", Zona Kadastrale 8512, që pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FLURXHI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO

